



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:285939

Datë: 22.04.2024

Numri i dokumentit: 05603158

PAKR.nr.169/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Krime të Rënda me kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hashim Çollaku- kryetar i kolegjit, Kadrije Goga Lubishtani dhe Xhevdet Abazi-anëtarë të kolegjit, me praktikanten gjyqësore Erna Stublla si procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit B. S për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 267 par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së), duke vendosur sipas ankesës së Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë dhe mbrojtësit të akuzuarit B. S, av. Bajram Zogiani, të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.191/2023 i datës 05.02.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 15.04.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHEN si të pabazuara ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë dhe mbrojtësit të akuzuarit B. S, av. Bajram Zogiani, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.191/2023 i datës 05.02.2024, VËRTETOHET.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda me aktgjykimin PKR.nr.191/2023 të datës 05.02.2024, të akuzuarin B. S për shkak të veprës penale blerja,

posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 267 par. 1 të KPRK-së, e ka shpallur fajtor dhe i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumën pesëqind euro (500 €), si dhe dënim me burgim në kohëzgjatje një (1) vit, të cilat dënime do të ekzekutohen brenda afatit 15 ditësh por jo më gjatë se tre muaj, pasi ky aktgjykim të merr formën e prerë.

Dënimin me gjobë i akuzuari mund ta paguaj deri në tre këste.

Nëse dënimi i shqiptuar në të holla nuk mund të ekzekutohet, Gjykata të akuzuarit do t'i caktoj një ditë burgimi për 20 € të gjobës.

Në dënimin e shqiptuar të akuzuarit do të i llogaritet edhe koha e kaluar nën masën e paraburgimit nga data 28.12.2022 deri me datë 24.03.2023, nga e cila datë ka qenë nën masën e arrestit shtëpiak deri me datë 25.05.2023.

Është urdhëruar konfiskimi dhe shkatërrimi i substancës narkotike të llojit “Marihuanë” në peshë të përgjithshme prej 439.29 gram, katër (4) peshore digjitale dhe një telefon i markës “iPhone”, të cilat janë përdorur për kryerjen e veprës penale, ndërsa 151.11 euro të përfituara me kryerjen e veprës penale, mbahen në shfrytëzim të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Këtë urdhër do ta ekzekutoj Policia e Kosovës apo Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar, varësisht ku gjenden sendet e konfiskuara si më lart.

Është obliguar i akuzuari që të i paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare, në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën pesëdhjetë euro (50 €), si dhe në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj shumën pesëdhjetë euro (50 €), në afat prej 15 ditësh por jo më gjatë se tre muaj, pasi ky aktgjykim të merr formën e prerë.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë kanë ushtruar:

Prokurori i Prokurorisë Themelore në Prishtinë, për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozimin që Gjykata e Apelit e Kosovës ta aprovoj ankesën e tij, të mbaj seancën konform nenit 398 par. 1 pika 1.4 të KPPRK-së dhe konform provave ta ndryshoj aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.191/2023 i datës 05.02.2024 konform propozimit të Prokurorisë në aktakuzë PP.I.nr.901/2022 e datës 17.05.2023 dhe provave të administruara në shqyrtimin kryesor dhe të paraqitura në ankesë.

Mbrojtësi i të akuzuarit B. S, av. Bajram Zogiani, për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, me propozimin që Gjykata e Apelit e Kosovës ta anuloj aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.191/2023 i datës 05.02.2024 dhe çështja të i kthehet Gjykatës së shkallës së parë në rivendosje ose ta ndryshojë aktgjykimin e ankimuar dhe atë vetëm përkitazi me sanksionin penal- dënimin me burg ashtu që të akuzuarit B. S për veprën penale për të cilën me aktgjykimin e ankimuar është shpallur fajtor dhe i shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje një (1) vit, ta merr si të vërtetuar por të urdhërohet që i njëjti të mos ekzekutohet por ta shndërroj në dënim me kusht. Ndërsa dënimi me gjobë në shumën pesëqind euro (500 €) të anulohet apo të zvogëlohet në minimum pasi që i akuzuari është në gjendje të vështirë ekonomike financiare dhe pagesa e këtij dënimi do të ndikoj drejtpërdrejt në rrezikimin e ushqimit të domosdoshëm të vet dhe të familjes së ngushtë të tij.

Prokuroria e Apelit me parashtresën PPA/I.nr.164/2024 e datës 15.03.2024, ka propozuar që të aprovet si e bazuar ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda PP/I.nr.901/2022 e datës 27.02.2024 e ushtruar kundër aktgjykimin të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.191/2023 i datës 05.02.2024, ashtu që të ndryshohet aktgjykimin i ankimuar dhe të akuzuarit B. S t'i shqiptohet dënim më i ashpër. Ndërsa të refuzohet si e pa bazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit B. S, av. Bajram Zogiani, e ushtruar kundër aktgjykimin të ankimuar.

Gjykata e Apelit të Kosovës, mbajti seancën e kolegjit konform dispozitës së nenit 390 paragrafi 1. të KPPK-së në të cilën ka marrur pjesë mbrojtësi i të akuzuarit B. S, av. Bajram Zogiani. Ndërsa, Prokurori i Apelit dhe i akuzuari B. S, nuk prezantuan në seancën e kolegjit, ndonëse të njoftuar në kohë dhe në mënyrë të rregullt. Mbrojtësi i të akuzuarit B. S, av. Bajram Zogiani në seancën e kolegjit deklaroi se qëndrojmë pranë pretendimeve të parashtruara në ankesë dhe atë sa i përket me burgim dhe me gjobë për të mbrojturin tim. Propozojmë që të mirren parasysh rrethanat lehtësuese, veçanërisht fakti që i akuzuari asnjëherë më parë nuk ka qenë në ndonjë procedurë penale dhe as i dënuar. I propozoj Gjykatës që të nxjerr aktgjykimin me të cilin do të ndryshohet aktgjykimin i Gjykatës së shkallës së parë përkitazi me sanksionin penal me të cilin i është shqiptuar dënim me burgim prej një viti dhe propozoj që të akuzuarit për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor këtë dënim të ia vërtetoj, mirëpo të i njëjti dënim të shndërrohet në dënim me kusht. Në lidhje me dënimin me gjobë në shumë prej 500 euro i propozoj Gjykatës që të zvogëlohet në minimum.

Gjykata e Apelit pasi shqyrtoi shkresat e lëndës, studioi aktgjykimin e kundërshtuar konform dispozitës së nenit 394 të KPPRK-së dhe pasi që vlerësoi pretendimet ankimore në ankesën e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë dhe mbrojtësit të akuzuarit B. S, av. Bajram Zogiani, gjeti se:

Ankesat janë të pabazuara.

Pretendimet ankimore të Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë

Prokurori në ankesë citon dispozitën e nenit 267 par.1 të KPRK-së, duke shtuar se Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar shqiptimin e dënimit nën minimumin ligjor e ka arsyetuar vetëm me rrethanën lehtësuese të pranimit të fajësisë nga i akuzuari (të cilin pranim e ka bërë pasi që Prokurori ka filluar dhënien e fjalës përfundimtare) dhe faktin që i akuzuari nuk është gjykuar më parë me aktgjykim të plotfuqishëm, si dhe me rrethanën rënduese të rrezikimit të shëndetit dhe jetës së qytetarëve që konsumojnë narkotik të cilët i dyshuari i ka vënë në qarkullim.

Pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit B. S, av. Bajram Zogiani

Mbrojtësi i të akuzuarit në ankesë thekson se bazuar në gjendjen e çrregullimit mendor me shifrën F- 19 (ICD-10) dhe çrregullimit të personalitet antisocial (F-60.2) të akuzuarit B. S si pasojë e përdorimit narkotikëve, e kundërshtojnë cilësimin e veprës penale në pjesën ku theksohet se i pandehuri ka bërë shitjen e substancave narkotike. Sipas mbrojtjes Prokuroria nuk ka arritur të arsyetoj dhe argumentojë me asnjë provë bindëse dyshimin e bazuar se i akuzuari ka kryer veprën penale shitje e narkotikëve. Po ashtu, bazuar në faktin se i akuzuari ka pohuar pranimin e veprës penale të konsumimit narkotikëve të cilët i ka poseduar, mbrojtja propozon që të ndryshohet cilësimi juridik i veprës penale dhe i akuzuari të përgjigjet për veprën penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve sipas nenit 269 par.1 të KPRK-së.

Për më tepër, mbrojtja pretendon Gjykata e shkallës së parë nuk është dashur të pranojë deklaratën e dëshmitarit të dytë të dhënë në polici, pasi që ky dëshmitar nuk është dëgjuar edhe në seancë gjyqësore. Andaj, referuar nenit 338 par.2 të KPPRK-së mbrojtja pretendon se kjo provë është dashur të konsiderohet si provë e papranueshme.

Ndërkaq, mbrojtja pretendon se trupi gjykues i Gjykatës së shkallës së parë me rastin e shqiptimit të dënimit nuk i ka vlerësuar sa duhet rrethanat lehtësuese për të akuzuarin, dhe atë faktin që i

akuzuari ka qenë shumë bashkëpunues dhe i sinqertë, e ka pranuar fajësinë se kundërligjshëm ka poseduar mjet narkotik (marihuanë) në banesën e tij dhe është konsumues i saj, faktin se i njëjti është një person i thjeshtë dhe qëllimi i vetëm i tij ka qenë sigurimi i kësaj sasive të narkotikut për përdorim personal, faktin se i akuzuari asnjëherë më parë nuk ka qenë në ndonjë procedurë gjyqësore penale e as i dënuar, faktin që i njëjti gjatë mbajtjes në paraburgim ka pasur sjellje të mirë, është penduar për veprime e bëra, kërkon falje, tani punon në liri në Call Center, është fejuar dhe dëshiron ti kthehet jetës normale familjare, faktin se ka deklaruar që me mbajtjen e narkotikëve dëmin më të madh i ka shkaktuar vetes dhe shëndetit të tij, si dhe premtimin që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla apo të tjera penale. Prandaj, duke marrur parasysh të gjitha këto, sipas mbrojtjes Gjykata është dashur të i shqiptoj të akuzuarit një dënim shumë më të butë alternativ me kusht sipas nenit 49 të KPRK-së, me të cilin do të arrihej rehabilitimi i të akuzuarit.

Vlerësimi i Gjykatës së Apelit

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, Gjykata e Apelit të njëjtin lidhur me shkeljet e tilla e shqyrtoi sipas detyrës zyrtare dhe konform nenit 394 par.1 të KPPK-së, gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e as shkelje të tjera të cilat detyrimisht do të kushtëzonin anulimin e tij.

Po ashtu, me ankesë nuk kontestohet as gjendja faktike të cilën e ka vërtetuar Gjykata e shkallës së parë, prandaj as në këtë drejtim çështja nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj Gjykate (pasi që nuk mund të kontestohet aktgjykimi përkitazi me këtë bazë ankimore meqë i akuzuari ka pranuar fajësinë). Prandaj, aktgjykimi u vlerësua vetëm lidhur me pretendimet ankimore të Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë dhe mbrojtësit të akuzuarit B. S, av. Bajram Zogiani, sa i përket vendimit mbi sanksionin penal.

Vlerësimi i Gjykatës lidhur me vendimin mbi dënim

Duke shqyrtuar aktgjykimin e ankimuar përkitazi me vendimin mbi dënimin, Gjykata e Apelit konstaton se pretendimet e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë dhe mbrojtësit të akuzuarit B. S, av. Bajram Zogiani janë të pabazuara.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të dënimit i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësisë së dënimit, duke vlerësuar kështu si rrethana lehtësuese pranimit e fajësisë

nga i akuzuari, sjelljen e të akuzuarit para dhe pas kryerjes së veprës penale, faktin që i njëjti sipas evidencës së kësaj gjykate nuk ka ndonjë aktgjykim të formës së prerë se ka qenë i dënuar më parë dhe keqardhjen e shprehur nga i akuzuari pas kryerjes së veprës penale. Ndërsa si rrethanë rënduese ka vlerësuar intensitetin e rrezikimit të vlerës së mbrojtur, sepse me vënien në qarkullim të narkotikëve të rrezikshëm rrezikohet shëndeti dhe jeta e qytetarëve të cilët konsumojnë këto substanca. Po ashtu, bazuar në dispozitën e nenit 72 par.1 nënpar. 1.4 të KPRK-së dhe në rrethanat e lartcekura, Gjykata e shkallës së parë e ka zbutur dënimin ndaj të akuzuarit, me bindjen se edhe me një dënim më të butë do të arrihet qëllimi i dënimit. Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo Gjykatë dhe gjen se Gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit.

Ndërsa, pretendimi i Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë se Gjykata e shkallës së parë nuk ka arsyetuar mjaftueshëm shqiptimin e dënimit nën minimumin ligjor të parashikuar për veprën penale e cila i vihet barrë të akuzuarit, është pretendim i pabazuar pasi që në aktgjykimin e ankimuar Gjykata e shkallës së parë ka radhitur taksativisht dhe mjaftueshëm të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në të cilat e ka bazuar vendimin për shqiptimin e dënimit nën minimumin ligjor. Gjithashtu, pretendimi i mbrojtësit të akuzuarit që duhet të bëhet ri cilësimi i veprës penale i cila i vihet barrë të akuzuarit, pretendimi që deklarata e dëshmitarit të dytë është provë e papranueshme si dhe pretendimi që Gjykata e shkallës së parë nuk ka vlerësuar mjaftueshëm rrethanat lehtësuese, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate janë pretendime të pabazuara, pasi që në rastin konkret i akuzuari ka pranuar fajësinë andaj gjendja faktike është e pa kontestueshme, ndërsa sa i përket pretendimit të tretë rrethanat lehtësuese të theksuara nga mbrojtja veç se kanë qenë objekt i vlerësimit të Gjykatës së shkallës së parë me rastin shqiptimit të dënimit. Andaj, të gjitha këto rrethana sipas vlerësimit edhe të kësaj Gjykate janë bazë e mjaftueshme për arsyetimin e dënimit të shqiptuar nga Gjykata e shkallës së parë si në dispozitiv të aktgjykimin të ankimuar.

Prandaj, kjo Gjykatë vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit nga ana e Gjykatës së shkallës së parë është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe më intensitetin e rrezikimit apo pasojave të shkaktuara dhe se më të do të mund të parandalohet i akuzuari nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe do të parandalohen personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Nga arsyet e lartcekura u vendos si në dispozitave të këtij aktgjykimi konform nenit 401 të KPPRK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Departamenti për Krime të Rënda
PAKR.nr.169/24, datë 15.04.2024

Praktikantja gjyqësore
Erna Stublla

Anëtarët e kolegjit
Kadrije Goga Lubishtani

Kryetar i kolegjit
Hashim Çollaku

Xhevdet Abazi
